REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 02- 416
Data/Datum/Date: 27/03/2026
Sintojca/Dodaci/Annex: -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

---

Nr. 27 /2026
Datë: 27 /03 /2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për funksionimin dhe organizimin e Administratës Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Agjencive të Pavarura, në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 59, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë lëshon:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e ofertave të aktivitetit të prokurimit me titull"Furnizim me kompjuter për MD dhe Njësit e saj", me nr. të prokurimit: 215-26-1253-5-5-8

2. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:
   2.1. Resim Novobërdaliu, UD. Udhëheqës i Divizionit të TI dhe Shërbime të Përgjithshme, IML– Kryesues i Komisionit.

   2.2. Burim Preteni Zyrtar i larte i TI-së, SHKK – Anëtar i Komisionit.

   2.3. Fisnik Makolli, Zyrtar i Lartë i TI-së, MD – Anëtar i Komisionit.

3. Anëtarët e Komisionit obligohen që, para fillimit të ushtrimit të detyrës, të plotësojnë dhe nënshkruajnë deklaratën nën betim, në përputhje me nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092..

4. Komisioni, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, vepron në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke respektuar me përpikëri, dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren nr. 002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, si dhe kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

5. Pas përfundimit të vlerësimit, Komisioni i paraqet Zyrtarit të Prokurimit, raportin përfundimtar të vlerësimit, rekomandimin përkatës, si dhe arsyetimin që mbështet këtë rekomandim.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Anita KALANDERI

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i'u dërgohet:

-Anëtarëve të Komisionit;
-Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
-Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Divizionit të Prokurimit;
-Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.